



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 529/3 Prot.

Tiranë, më 31.03.2026

V E N D I M

Nr. 67, datë 31.03.2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 70 Regj., datë 10.03.2026, të shtetases B. Sh., kundër Radio Televizionit Shqiptar, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes shoqërore”, “përkatësia në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, B. Sh., pranë KMD-së, ndër të tjera, citohet si më poshtë vijon: *Unë kam një marrëdhënie pune të gjatë dhe të konsoliduar pranë këtij institucioni që prej vitit 2017, gjatë së cilës kam ushtruar me përkushtim dhe profesionalizëm funksione të rëndësishme në procesin e prodhimit dhe realizimit të programeve televizive. Fillimisht kam ushtruar detyrën e redaktores, ndërsa në vijim kam kryer në mënyrë efektive edhe detyrat e regjisoresh, duke realizuar programe dhe transmetime televizive "live", një pjesë e konsiderueshme e të cilave lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pozicionit për të cilin u zhvillua konkursi. Pavarësisht kësaj përvoja shumëvjeçare, të dokumentuar dhe të lidhur drejtpërdrejt me funksionin për të cilin u konkurrua, procedura e zhvilluar nga institucioni rezulton të jetë zhvilluar*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

në kushte të mungesës së plotë të transparencës dhe të kriterëve objektive, duke krijuar një situatë thellësisht të padrejtë dhe të pabarabartë në raport me kandidatët e tjerë. Konkretisht:

- procedura e konkursit është zhvilluar pa shpalljen paraprake të kriterëve profesionale dhe të kriterëve të vlerësimit, duke bërë që kandidatët të mos kenë dijeni mbi standardet mbi të cilat do të vlerësoheshin;*
- nuk është bërë publik asnjë sistem pikëzimi apo metodologji vlerësimi, gjë që e bën të pamundur verifikimin e objektivitetit të procesit;*
- mua nuk më është dhënë asnjë mundësi reale për të njohur dokumentacionin e plotë të vlerësimit, përfshirë pikëzimin, procesverbalet apo vlerësimet individuale të komisionit;*
- gjithashtu, nuk jam informuar mbi arsyet konkrete dhe të argumentuara që kanë çuar në moshpalljen time fituese.*

Në këto kushte, mënyra se si është zhvilluar kjo procedurë ka krijuar një situatë ku procesi i konkurrimit është zhvilluar pa garanci reale për barazi, objektivitet dhe transparencë, duke e bërë praktikisht të pamundur që kandidatët të verifikojnë nëse vlerësimi është bërë mbi baza profesionale apo mbi kriterë të tjera të paqarta dhe të paformalizuara. Për mua, kjo situatë përbën jo vetëm një zhgënjim të thellë profesional pas një kontributi shumëvjeçar në të njëjtin institucion publik, por edhe një cenim të drejtpërdrejtë të të drejtës për trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punës dhe për një proces konkurrimi të drejtë dhe transparent. Mungesa e transparencës, mungesa e kriterëve të paracaktuara dhe pamundësia për të verifikuar procesin e vlerësimit krijojnë indicie serioze për trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, duke cenuar parimin e barazisë së mundësive në punësim dhe zhvillim profesional. (Ankuesja ka bërë në mënyrë narrative renditjen e ngjarjeve dhe historikun e saj në institucion.)

Për këto arsye, i drejtohem Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me kërkesën për të shqyrtuar këtë rast dhe për të verifikuar nëse procedura e zhvilluar nga Radio Televizioni Shqiptar ka respektuar standardet ligjore të barazisë dhe mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- 1. Fillimin e hetimit administrativ mbi procedurën e konkursit për pozicionin "Regjisor Sporti", të zhvilluar më datë 29.01.2026 pranë Radio Televizionit Shqiptar, për verifikimin e përputhshmërisë së saj me parimet e barazisë, transparencës dhe mosdiskriminimit.*
- 2. Konstatimin e ekzistencës së diskriminimit procedural dhe të cenimit të parimit të barazisë në konkurrim, për shkak të mungesës së kriterëve të shpallura paraprakisht, mungesës së transparencës në procesin e vlerësimit dhe pamundësisë për verifikimin objektiv të përzgjedhjes së kandidatit fitues.*
- 3. Rekomandimin për rishikimin e procedurës së zhvilluar dhe organizimin e një procedure të re konkurrimi, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, meritokracisë dhe trajtimit të barabartë të të gjithë kandidatëve.*

4. Marrjen e masave institucionale të nevojshme për të garantuar respektimin efektiv të parimit të barazisë, transparencës dhe mosdiskriminimit në procedurat e punësimit dhe të zhvillimit profesional pranë Radio Televizionit Shqiptar.
5. Në mënyrë të veçantë, kërkohet administrimi dhe vënia në dispozicion e dokumentacionit të mëposhtëm:
 - Shpalljes së konkursit dhe kriterëve të përzgjedhjes;
 - Metodologjisë së vlerësimit dhe sistemit të pikëzimit të kandidatëve;
 - Procesverbaleve dhe akteve të komisionit të vlerësimit;
 - Tabelave të pikëzimit dhe vlerësimeve individuale të kandidatëve;
 - Çdo akti tjetër administrativ që lidhet me organizimin dhe zhvillimin e procedurës së konkurrimit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjen shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektet nga të cilët pretendon se diskriminohet, apo me të drejtën ligjore të saj.

Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës nr.529/1 prot., datë 11.03.2026 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar subjektit ankues, si më poshtë vijon:

- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkaqet e pretenduara për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju i mbartni këto shkaqe të pretenduara.
- Përveç përshkrimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek titullari i Radio Televizionit Shqiptar nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
- Referuar informacionit të dhënë nga ana juaj në Formularin e ankesës jeni shprehur se këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht; nëse po, të na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë së depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, pala ankuese ka depozituar me nr. 529/2 prot., datë 18.03.2026, pranë Komisionerit informacion dhe dokumentacion shtesë lidhur me këtë çështje.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Pjesë e dokumentacionit të paraqitur, është edhe kërkesë-padia e depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse znj. Briselda Shehu dhe palë të paditur institucionin publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH).

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala paditëse në këtë proces, konstatohet se në objekt dhe në analizë të kërkesë-padisë, pretendimet e ngritura lidhen drejtpërdrejt me shkeljen e të drejtave themelore të njeriut në marrëdhëniet e punës, konkretisht me trajtim të pabarabartë, mungesë transparence dhe diskriminim procedural në kuadër të një procedure konkurrimi për pozicion pune.

Nga shqyrtimi i kërkesë-padisë rezulton se paditësja ka pretenduar se procedura e konkurrimit për pozicionin “Regjisor Sporti”, e zhvilluar më datë 29.01.2026, është realizuar në kundërshtim me parimet themelore të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke mos garantuar kushte të barabarta për pjesëmarrje dhe vlerësim. Konkretisht, ajo ka pretenduar se nuk i janë bërë të njohura kriteret e vlerësimit, metodologjia e pikëzimit dhe elementet procedurale, çka ka krijuar një disavantazh real dhe një trajtim të pabarabartë në raport me kandidatët e tjerë.

Në këtë kontekst, në kërkesë-padi është theksuar se mungesa e transparencës, e dokumentimit dhe e arsyetimit të vendimmarrjes administrative përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe krijon hapësirë për trajtim diskriminues. Paditësja ka pretenduar se nuk ka pasur akses të

barabartë në informacion dhe dokumentacion, duke u vendosur në një pozitë më të pafavorshme në procesin e konkurrimit.

Gjithashtu, në parashtrimet e kërkesë-padisë evidentohet se mosmarrja në konsideratë e përvojës profesionale të paditëses dhe mungesa e kriterëve të njëjta e të verifikueshme për të gjithë kandidatët, krijojnë prezumimin e një trajtimi të pabarabartë dhe për rrjedhojë të një diskriminimi procedural në kuptim të legjislacionit vendas dhe standardeve ndërkombëtare.

Paditësja ka argumentuar se këto veprime bien në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili garanton barazinë përpara ligjit dhe ndalon diskriminimin, si dhe me nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative, që sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në veprimtarinë e organeve publike. Po ashtu, është referuar edhe neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili ndalon çdo formë diskriminimi në gëzimin e të drejtave.

Në të njëjtën linjë, në kërkesë-padi është pretenduar edhe cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së një procedure transparente, të arsyetuar dhe të kontrollueshme. Sipas paditëses, vendimmarrja administrative ka qenë arbitrare, e paarsyetuar dhe pa garanci për trajtim të paanshëm.

Gjithashtu, paditësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, duke argumentuar se është penguar padrejtësisht në aksesin në një pozicion pune dhe në vijimin e marrëdhënies së saj profesionale, si pasojë e një procedure jo të rregullt dhe jo të barabartë.

Në këtë kuadër, konstatohet se një nga kërkimet kryesore të padisë është shprehimisht: *“Konstatimi i diskriminimit procedural dhe cenimit të parimit të barazisë në konkurrim”*, krahas kërtimeve të tjera si shpallja e pavlefshmërisë së procedurës së konkursit, pezullimi i efekteve të saj dhe detyrimi i institucionit për zhvillimin e një procedure të re, ligjore dhe transparente.

Bazuar në analizën e kërkesë-padisë paraqitur para Gjykatës, paditësja, znj. B. Sh., ka pretenduar *inter alia* trajtim të padrejtë dhe diskriminues në marrëdhëniet e punës, zgjidhjes së marrëdhënies së punës si dhe në vijim të procedurës së konkurrimit për pozicionin “Regjisor Sporti”. Ajo ka kërkuar, ndër të tjera, shpalljen e pavlefshmërisë së procedurës së konkurrimit, konstatimin e diskriminimit procedural dhe cenimit të parimit të barazisë në konkurrim, si dhe pezullimin e efekteve të procedurës dhe detyrimin e institucionit për zhvillimin e një procedure të re, ligjore dhe transparente.

Bazuar në sa më sipër, rezulton se paditësja ka investuar gjykatën administrative me pretendime të drejtpërdrejta për shkelje të të drejtave themelore, përfshirë trajtimin diskriminues në marrëdhëniet

e punës dhe cenimin e barazisë në konkurrim, duke kërkuar ndërhyrjen gjyqësore për rivendosjen e këtyre të drejtave.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt kërkitimi dhe shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 70 Regj., datë 10.03.2026, të znj. B. Sh., dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj³.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁴, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

³ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021; nr. 27, datë 16.02.2021; nr. 77, datë 07.05.2021; nr. 230, datë 25.11.2021; nr. 253, datë 28.12.2021; nr. 77, datë 21.04.2022; nr. 108, datë 20.06.2023; nr. 145, datë 26.07.2023; nr. 89, datë 03.04.2024; nr. 25, datë 30.01.2025; nr. 269, datë 26.11.2025, të Komisionerit.

⁴ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 70 Regj., datë 10.03.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, znj. B. Sh., për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA